



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
SEKRETARIA

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.09.2021

**MBLEDHJA Nr. 46,**  
**datë 01.10.2021, ora 10:30**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 01.10.2021, ora 10:30**, do të zhvillohet mbledhja nr. 46 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e kërkesës për aplikim nga Gek Terna Grup, për fazën jo të detyrueshme në treg- testi i TAP AG, për kapacitetin dhe lidhjen e termocentralit me cikël të kombinuar me fuqi 160-180 MW në Roskovec, Fier
2. Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e bordit të ERE-s nr. 185, datë 10.09.2021 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 11, seria PV03K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Spahiu Gjanç” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 20, datë 19.12.2003” dhe përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.09.2021 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 224, seria T14P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Spahiu Gjanç” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 14, datë 03.03.2014”
3. Për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, i ndryshuar dhe një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, i ndryshuar
4. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë OSSH sh.a. për përcaktimin e çmimit të faturimit të energjisë reaktive
5. Cështje të tjera

Në zbatim të: (i) pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19”; (ii) Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”; (iii) Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020,

“Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”; dhe (iv) Urdhërit nr. 19, datë 19.02.2021, “Për ndryshimin e pikës 1, të Urdhërit nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”, për lejimin e pjesëmarrjes së palëve të treta, nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik, për sa i përket zhvillimit të mbledhjeve të hapura të Bordit, si dhe zhvillimin e seancave dëgjimore teknike apo publike.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**